

PROCESVERBAL - Tipi i kontratës - Shërbime

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

- **“SHËRBIMI I MIREMBAJTJES SE RRJETIT HIDRIK PËR 3 VITE”**.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

- **Shërbime për menaxhimin e kanalizimeve – 90480000-5.**

VLERA E FONDIT LIMIT:

45.000.000 (dyzet e pesë milion) lekë, pa TVSH/457.549,57 (katërqind e pesëdhjetë e shtatë mijë e pesëqind e dyzet e nëntë presje pesëdhjetë e shtatë) euro pa tvsh

-

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor, Autoriteti Portual Durrës, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore, të lëshuar nga Administrata Tatimore, për vitet financiare (2022-2023-2024) ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar, të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, dhe në nenin 43 pika 2.a të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të të ardhurat”, i ndryshuar, neni 29 dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2022, 2023, 2024 ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare

2.3 Kapaciteti teknik:

1. Për të provuar përvojën e mëparshme, kandidati/ofertuesi duhet të ketë realizuar:

- Dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, për një vlerë jo më të vogël se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Si dëshmi për përvojën e mëparshme Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

- a) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik, si dëshmi për përvojën e mëparshme, duhet të paraqiten vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 41, pika 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik". Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet/punët e mëparshme të ngjashme, që janë kryer gjatë 3 viteve të fundi nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, të jenë në masën minimale prej 40 % të vlerës së fondit limit, dhe që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenet e sipërcituara.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Në përputhje me limitet maksimale të përcaktuara në VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" neni 47. Janë zgjedhur limitet maksimale që punët të jenë të ngjashme (sa më të afërta) edhe në sasi (vlerë).

2. Licencat profesionale:

Subjektet pjesëmarrëse në konkurim duhet të zotërojnë, Licenca profesionale të Zbatimit, referuar Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 42, datë 16.01.2008, "Për Miratimin E Rregullores Për Kriteret dhe Procedurat e Dhënies së Licencave Profesionale të Zbatimit, Klasifikimit dhe Disiplinimit të Subjekteve Juridike, që Ushtrojnë Veprimtari Ndërtimi" i ndryshuar të lëshuar nga Komisioni i Posaçëm i dhënies së licencave profesionale, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

- ☐ **NP-1 A, Punime gërmimi në tokë.**
- ☐ **NP-2 A, Ndërtime civile dhe industriale.**
- ☒ **NP-4 A, Rrugë, autostrada, mbikalime etj**

- ❑ **NP-7 A, Ujësjetllës, kanalizime, vepra kullimi e vaditje.**
- ❑ **NS-2 A, Impiante hidro-sanitare, kuzhina, lavanteri mirëmbajtja e tyre.**
- ❑ **NS-18 A, Punime topogjeodezike.**

Në rast të bashkimit të operatorëve ekonomik, licencat profesionale duhet ti paraqesë operatori ekonomik që ka marrë përsipër punimet për të cilat kërkohet licenca profesionale.

Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastruktës dhe Energjisë, (ose Ministrisë kompetente të kohës) Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM- ne, Nr.42, datë 16.01.2008). Mosparaqitja në këto forme është kusht skualifikues.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe VKM- nr. 42, datë 16.1.2008 “Për Miratimin E Rregullores Për Kriteret Dhe Procedurat E Dhënies Së Licencave Profesionale Të Zbatimit, Klasifikimit Dhe Disiplinimit Të Subjekteve Juridike, Që Ushtrojnë Veprimtari Ndërtimi” i ndryshuar, projekt-preventivin e projektit, VKM nr. 629, datë 15.07.2015, “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre” i ndryshuar, Udhëzim nr.3, datë 15.2.2001 “Për Mbikëqyrjen Dhe Kolaudimin E Punimeve Të Ndërtimit”.

(Shënim: përcaktoni aktin ligjor ose nënligjor që parashikon licencimin në fushën e zbatimit të punimeve të ndërtimit, kategoritë e nevojshme të licencës, me emërtimin e tyre në përputhje me legjislacionin e fushës, duke përcaktuar edhe nivelin minimal të klasifikimit për çdo kategori, sipas vlerave të punimeve konkrete që do kryhen, si dhe institucionin që lëshon këtë licencë).

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

Kategoria e kërkuar	Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive	Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
NP-1 A	Punime gërmimi në tokë	- Germim	0-20 mln leke	
NP-2 A	Ndërtime civile dhe industriale.	- Struktura monolite	0-20 mln leke	
NP-4 A	Rrugë, autostrada, mbikalime etj	- Shtresa asfalti	0-20 mln leke	
NP-7 A	Ujësjetllës, kanalizime, vepra kullimi e vaditje	- F.V Tub PEHD 75/20	0-20 mln leke	

NS-2A	Impiante hidro-sanitare, kuzhina, lavanteri mirëmbajtja e tyre.	NYJE SANITARE ,WC,BOLIER ETJ..		
NS-18 A	Punime topogjeodezike	Rilevim topografik, piktetm, kanaleve, pusetave	0-20 mln leke	Perfshihet ne te gjithë zërat

3 Stafi dhe Fuqia Punëtore

Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor, drejtues teknik** në licencën e shoqërisë, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, librezë pune, diplomë përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për 3 muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, si më poshtë:

- 1 (një) Inxhinier Ndërtimi;
- 1 (një) Inxhinier Hidroteknik;
- 1 (një) Inxhinier Gjeodet.
- 1 (një) Inxhinier Gjeoteknik

1 nje Inxhinier Ndërtimi	punime për mbushje dhe gërmim; punime për trupin e rrugës; punime bordure + kunetë; punime në trotuar; punime për struktura
1 (një) Inxhinier Hidroteknik	punime në ujësjelles, kanalizime dhe ujërat e shiut
1 (një) Inxhinier Topograf	punimet topogjeodezike, rlevime, etj...
1 (një) Inxhinier Gjeoteknik	punimet në fushën e inxhinierisë gjeoteknike, përfshirë analiza dhe projektimin e bazamenteve, sondazheve gjeoteknike dhe mbikëqyrjen e projekteve të ndërtimit

Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë prezencën në objekt të personelit stafit kryesor dhe mbështetës të mësipërm dhe/ose të kërkojë ndryshimin/zëvendësimin e tyre me staf me kualifikime të njëjta ose më të larta, në rast konstatimi të shkeljeve të rregullave/normave përkatëse. Në rast përsëritje mund të merrem masa për ndërprerjen e kontratës.

Ky kriter përmbushet me plotësimin e formularit të vetdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST.

Ofertuesi i kualifikuar, i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit për të dëshmuar disponimin e tyre duhet të paraqesë dokumentacionin provues origjinal ose kopje të noterizuar:

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Numri i stafit kryesor teknik si numri i inxhinierëve të ndërtim, elektrik dhe hidroteknik është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Drejtuesi i projektit është përgjegjës për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës.

(Shënim: listoni dokumentacionin provues që dëshmon disponimin e stafit kryesor, mbështetës dhe të specializuar/kualifikuar të kërkuar, dhe nëse është rasti kërkesat për licencat profesionale individuale, apo certifikimet/kualifikimet që duhet të disponojnë anëtarët e stafit, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi, si dhe insitucionin që lëshon këto licenca apo certifikime/kualifikime).

- 4 Kandidati/Operatori Ekonomik Ofertues duhet të ketë numrin e nevojshëm të stafit për realizimin dhe zbatimin e shërbimit. Numri i punonjësve të siguruar duhet të jetë jo më i vogël se 35 punonjës për 3 muajt e fundit nga data e hapjes së ofertës.

Për plotësimin e këtij kriteri, duhet të paraqitet:

- Vërtetim nga Administrata Tatimore, si edhe listëpagesat e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, sipas formularit E/SIG-25, për të gjithë periudhën e kërkuar.
- Operatori ekonomik duhet të deklarojë disponibilitet të numrit të kërkuar të punonjësve për gjatë gjithë periudhës së realizimit të shërbimit, konform parashikimeve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Ky kriter përmbushet me plotësimin e formularit të vetdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST.

Ofertuesi i kualifikuar, i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit për të dëshmuar disponimin e tyre duhet të paraqesë dokumentacionin provues origjinal ose kopje e noterizuar:

Argumentimi: Në përcaktimin e numrit të punonjësve specialisti i fushës ka bërë një analizë bazuar tek faktorët, si volumet dhe kategoritë e punimeve, kualifikimi i punonjësve, grafiku i punimeve, zërat e punimeve dhe orët e punës etj.. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështrirje gjashtë muajt e fundit, tregon besueshmëri për autoritetin që, operatori do të përmbushë kontratën. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë janë në përpjesëtim me

natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë vërtetimi i lëshuar nga administrata tatimore e shoqëruara me listpagesat me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve, përvojën e tyre, dhe janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përpiket të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës.

(Numri i punonjësve, i mjeteve/makinerive që nevojiten për realizimin e kontratës është përcaktuar bazuar në ligjin Nr. 8402 date 10.09.1998 “Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit”, i ndryshuar dhe akteve nenligjore).

5.Kandidati/Operatori Ekonomik Ofertues, duhet të paraqesë një deklaratë me shkrim nga Administratori i shoqërisë, ku të deklarojë se, stafi deklaruar në tender për mirëmbajtjen e shërbimit hidrik pranë APD, nuk do të jenë të angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jenë në dispozicion të këtij objekti deri në përfundimin e kontratës.

Argumentimi: Kjo kerkese eshte vendosur bazuar ne ligjin nr. 162/2020, Per prokurimin publik, mbi besueshmerine, neni 77, pika 4 si dhe verifikimin e informacionit te paraqitur ne tender, dhe ne rast te paraqitjes se informacionit dhe dokumentacionit me te dhena te rreme per qellime kualifikimi, si dhe besueshmerise qe stafi i kerkuar do te jete ne dispozicion te ketij objekti, deri ne perfundimin e punimeve.

6.Kandidati/Operatori Ekonomik Ofertues, duhet të ketë pjesë të stafit të tij, të cilët duhet të figurojnë në listpagesën e shoqërisë ofertuese, për të gjithë periudhën e kërkuar, të paktën:

- 2 teknikë ndërtimi,
- 1 teknik hidraulik
- 10 hidraulikë
- 2 hidroizolues
- 2 muratorë / suvatues
- 4 saldatorë
- 2 betonues
- 1 pllakashtrues
- 2 shoferë
- 4 drejtues manovratorë

Për plotësimin e këtij kriteri, duhet të paraqiten në procedurën e prokurimit publik, kontratat e punës të vlefshme, një dokument që të vërtetojë kualifikimin profesional (deshmi kualifikimi profesional / certifikate / diplome) lëshuar nga institucione të licensuara/akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore sipas ligjit nr.15/2017 Per arsimin dhe formimin profesional ne Republiken e Shqiperise” dhe deshmi e sigurimit teknik lëshuar nga ISHTI ose nga një trup certifikues e akredituar nga DPA ose nga organizmat ndërkombetare akredituese të njohur nga Republika e Shqipërisë si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për 3 muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave.

Ky kriter përmbushet me plotësimin e formularit të vetdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST.

Ofertuesi i kualifikuar, i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit për të dëshmuar disponimin e tyre duhet të paraqesë dokumentacionin provues origjinal ose kopje e noterizuar:

Argumentimi: Kjo kërkesë është vendosur bazuar në nenin 77/4 të ligjit nr. 162/2020, Për prokurimin publik, e cila ka lidhje teknike me objektin që prokurohet dhe është proporcionale me objektin e kontratës. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. Disponueshmëria dhe reagimi në kohë ndaj avarive të ndryshme që mund të ndodhin gjatë shfrytëzimit të rrjetit hidrik, kërkon që numri i punonjësve të jetë i mjaftueshëm për përballimin e këtyre situatave duke siguruar vazhdimësinë e shërbimit të furnizimit me ujë. Duhet pasur parasysh që shërbimet portuale janë 24 orëshe gjithashtu edhe vetë shtrirja e portit në një sipërfaqe të konsiderueshme kërkon një monitorim dhe mirëmbajtje më impenjative. Ndërhyrjet në linjat e tubacioneve duhen kryer të mirëorganizuar për riparimet e defekteve dhe rivendosjen e infrastrukturës në gjëndje funksionale brenda afateve për të mos penguar qarkullimin e mjeteve dhe mallrave.

7. Operatori/et ekonomik duhet të kenë në stafin e tyre 1 (një) punonjës, pajisur me certifikatë për "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë" në përputhje me Ligjin Nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M Nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier", shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, diplome/certifikate.

Në rastin e Bashkimit të Operatorëve ekonomikë, secili prej Operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) punonjës "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë, shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, diplome/certifikate.

Ky kriter përmbushet me plotësimin e formularit të vetdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST.

Ofertuesi i kualifikuar, i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit për të dëshmuar disponimin e tyre duhet të paraqesë dokumentacionin provues origjinal ose kopje e noterizuar:

Argumentim: Kjo kërkesë është në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier". Për këtë duhet të paraqitet certifikata e trajnimit për "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë", e dhënë nga një organizëm i licensuar, shqiptar ose i huaj si dhe kontrata e punës.

8. Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë pjesë të stafit të punësuar 1 (një) mjek të përgjithshëm i cili të jetë me kontratë pune të vlefshme dhe të jetë i pajisur me licencë të Urdhërit të Mjekut, dipolmë, CV.

Ky kriter përmbushet me plotësimin e formularit të vetdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST.

Ofertuesi i kualifikuar, i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit për të dëshmuar disponimin e tyre duhet të paraqesë dokumentacionin provues origjinal ose kopje e noterizuar:

Argumentim: Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij 1(një) mjek në bazë të paragrafit 12/2 të VKM Nr. 692, datë 13.12.2001 "Për Masat e Vecanta të Sigurimit dhe Mbrojtjes së Shëndetit në Punë, i ndryshuar dhe të Ligjit Nr.10237, datë 18.02.2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë", VKM Nr.108, datë 9.2.2011 " Për aftësi që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të

shëndetit në punë” (i ndryshuar), i cili të ketë kontratë pune, diplomë, licensë Urdhër Mjeku dhe të figurojë në listëpagesat e operatorit ekonomik ofertues.

9. Operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë në stafin e tij të paktën një ekspert privat zjarrëfikës. Për të vërtetuar plotësimin e këtij kriteri duhet të paraqesë kontratën e punës, licencën për mbrojtjen kundër zjarrit, si dhe QKL me kodin I.2.A.

Ky kriter përmbushet me plotësimin e formularit të vetdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST.

Ofertuesi i kualifikuar, i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit për të dëshmuar disponimin e tyre duhet të paraqesë dokumentacionin provues original ose kopje e noterizuar:

Argumentim: Ky kriter është në përputhje me pikën 4, të nenit 49, të Ligjit Nr.152/2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin.” Një ekspert i kualifikuar mund të identifikojë rreziqet e mundshme të zjarrit në kantier dhe të marrë masa për t'i zbutur ato. Ky proces përfshin hartimin e planeve të evakuimit dhe emergjencës, si dhe implementimin e sistemeve dhe pajisjeve të nevojshme për parandalimin e zjarreve. Eksperti është përgjegjës për trajnimin e punonjësve në përdorimin e pajisjeve zjarrfikëse dhe në procedurat e sigurisë nga zjarri. Trajnimi duhet të ofrohet të paktën një herë në vit dhe të rifreskohet sa herë që ka ndryshime në vend ose procedura.

10. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

<i>Lloji Makinerive</i>	<i>SASIA</i>	<i>PRONESIA</i>
<i>Vinc kulle 0.5 – 1 ton</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës minimum 3.5(tre pike pesë) ton dhe maksimumi 5(pesë) ton për secilin kamion</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Kamionçinë (kapaciteti mbajtës minimum 1.5(nje pik pesë) ton dhe maksimumi 2(dy) ton për secilin kamionçinë</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Automjet teknologjik për inspektimin e kolektorëve e pajisur me dy ose me shume sisteme kamerash për gjatesi inspektimi jo me pak se 200 m</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Motopompe për largimin e ujrave të ndotura dhe presion pune jo me të vogël se 8 bar.</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Autobetoniere kantieri me kapacitet 2.5-3 m3 (mjet teknologjik me goma)</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>

<i>Betoniere Kantieri</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Eskavator me goma (mjet teknologjik me goma)</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Eskavator me zinxhire me cekic pneumatic</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Minifadrome (mjet teknologjik me goma)</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Minieskavator</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Fadrome me goma (mjet teknologjik me goma)</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Miniasfaltoshtruese</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Dumper (mjet teknologjik me goma)</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Rrul asfalti me gome - gome (Kapaciteti jo me pak se 4 ton)</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
LLOJI I PAISJEVE	SASIA	PRONESIA
<i>Gjenerator korenti</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Vibrator Betoni</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Kompaktor Bazamenti me Pllakë</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Sharre me disk per prerje betoni</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Matrapik</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Kompresor</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Pajisje per testimin e presionit te ujit(Perbere nga pompa manuale e presionit,sensor per matjen e temperatures,sensor per matjen e</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>

<i>presionit,ekranin, pajisja digjitale te shoqerohet me foto dhe katalog)</i>		
<i>Pajisje e dixhitale e lëvizshme me ultratinguj për matjen e rrjedhjes/prurjes</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Detektor rrjetesh nentokesore paisur me monitor LCD, Wireless, GPS, Bluetooth per thelesi mbi 7m</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Set semaforesh</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>

- Për mjetet në pronësi duhet të paraqitet: a) dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (akti i pronësisë); b) leje qarkullimi; c) çertifikate e kontrollit teknik; d) siguracion mjeti, (i vlefshëm); e) çertifikatë për transport mallrash brënda vëndit (e vlefshme).
- Për mjetet e deklaruar me qera duhet të paraqitet: a) kontrata përkatëse noteriale e qerasë e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi b) dokumenti që verteton regjistrimin e tij (akti i pronësisë) c) leje qarkullimi; ç) çertifikaten e kontrollit teknik, d) siguracion mjeti (i vlefshëm); e) çertifikatë për transport mallrash brënda vëndit (e vlefshme).
- Për mjetet e deklaruar që transportojnë mallra të klasifikuara sipas legjislacionit në fuqi të rrezikshme, duhet të paraqitet çertifikatë për transport mallrash të rrezikshëm lëshuar nga institucionet perkatese (e vlefshme).
- Për pajisjet teknike, të cilat janë në pronësi të operatorit ekonomik, duhet të paraqitet kontrata e shitblerjes/fatura tatimore e shitjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes ndërsa kur janë të marra me qera duhet të paraqitet kontrata e qerasë, fatura tatimore e shitjes/ kontrata e shitblerjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes. Në rastin kur fatura është lëshuar nga subjekte që nuk janë të regjistruar si tatimpagues të TVSH-së duhet të shoqërohet me kuponin tatimor.
- Për mjetet dhe pajisjet teknike që ka deklaruar operatori ekonomik duhet të paraqesë foto të qarta për secilin mjet dhe pajisje. Në rastin e mjeteve të targuara duhet të jetë e dukshme në një foto të vetme mjeti dhe targa e tij.

Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruar.

Ky kriter përmbushet me plotësimin e formularit të vetdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST.

Ofertuesi i kualifikuar, i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit për të dëshmuar disponimin e tyre duhet të paraqesë dokumentacionin provues origjinal ose kopje e noterizuar:

(Numri i punonjësve, i mjeteve/makinerive që nevojiten për realizimin e kontratës është përcaktuar bazuar në ligjin Nr. 8402 date 10.09.1998 “Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit”, i ndryshuar dhe akteve nenligjore).

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ç të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Numri dhe lloji i makinerive, paisjeve ne pronesi / qira janë vlerësuar si të nevojshme në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke ju referuar punimeve sipas standardeve, orëve të punës, grafikut dhe kohëzgjatjes së punimeve, specifikimeve teknike. Për të zbatuar kontratën, operatorët ekonomik duhet të përmbushin kapacitetet teknike të pajisjeve dhe aseteve të tjera fizike, për këtë janë përcaktuar edhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët. Nëpërmjet kapaciteteve teknike operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë aftësinë dhe kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative. Pajisje dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës si dëshmi për mjetet dhe pajisjet sipas specifikave.

(Shënim: përcaktimi i aktin ligjor apo nënligjor, në bazë të të cilit është bërë përlllogaritja teknike e numrit të punonjësve dhe mjetet/makineritë/pajisjet e nevojshme për zbatimin e kontratës).

-
11. Kandidati/Operatori Ekonomik Ofertues duhet të paraqesë në procedurën e prokurimit publik një deklaratë me shkrim nga administratori i shoqërisë ofertuese, ku të deklarojë se, makineritë e kërkuara, nuk do të jenë të angazhuara në kontrata të tjera, si dhe do të jenë në dispozicion të këtij kontrate pergjate gjithë periudhes së zbatimit si dhe pranon verifikimin e mjeteve dhe pajisjeve të deklaruara në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentimi: Kjo kerkese eshte vendosur bazuar ne ligjin nr. 162/2020, Per prokurimin publik, mbi besueshmerine, neni 77. Nepermjet kesaj deklarate krijohet besueshmeria ne dhenin dhe paraqitjen e dokumentacionit ne tender, pasi shoqerite duhet te deklarojne se makinerite do te jene ne dispozicion te objektit, per realizimin me sukses te kontrates.

-
12. Kandidati/Operatori Ekonomik Ofertues, duhet të paraqesë në tender një deklaratë me shkrim nga administratori i shoqërisë, ku të deklarojë vendndodhjen e mjeteve të kërkuara në procedurën e prokurimit publik, si dhe të deklarojë se do të paraqesë me shpenzimet e veta të gjitha mjetet dhe pajisjet e kërkuara në dokumentet e tenderit, pranë Entit/Autoritetit Kontraktor, në rast se do të lindi nevoja për verifikimin e tyre, përpara shpalljes së klasifikimit.

Argumentimi: Kjo kerkese eshte vendosur bazuar ne ligjin nr. 162/2020, Per prokurimin publik, mbi besueshmerine, neni 77. Nepermjet kesaj deklarate krijohet besueshmeria ne dhenin dhe paraqitjen e dokumentacionit ne tender, pasi shoqerite duhet te deklarojne se makinerite do te jene ne dispozicion te objektit, per realizimin me sukses te kontrates, si dhe ne rast se do te lindin dyshime dhe nevoja per verifikimin e tyre, shoqerite duhet te paraqesin mjetet e kerkuara, me qellim verifikimin fizik te tyre.

CERTIFIKIME TE SUBJEKTIT

13.Operatori ekonomik duhet të vërtetojë se e zhvillon aktivitetin e tij në fushën objekt prokurimi në përputhje me standardet e menaxhimit të cilësisë, të shëndetit e sigurisë në punë, mjedisit dhe sigurisë së informacionit. Për këtë duhet të paraqesë certifikatat e mëposhtme, të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë:

- Certifikate per Sistemin e manaxhimit te cilesise (ISO 9001:2015) ose ekuivalente (e vlefshme).
- Certifikate per Sistemin e manaxhimit te mjedisit (ISO 14001:2015) ose ekuivalente (e vlefshme).
- Certifikate per Sistemin e manaxhimit te shendetit dhe sigurimit ne pune (ISO 45001:2018) ose ekuivalente (e vlefshme).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 44 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

.Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që si kompani kanë kualifikimet/certifikimet e duhura organizative dhe operationale të nevojshme për të zbatuar kontratën.

14. Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur, ose të ketë lidhur marrëdhënie kontraktuale me një operator tjetër të pajisur, me licencat nga Qendra Kombetare e Licensimit (QKL) sipas specifikimeve të ligjit nr.10463 datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” si dhe ligjin nr.52/2020 datë 01.07.2020 “Për lejet e mjedisit” i ndryshuar, si më poshtë:
- Licencë kategoria III.2.B për “Transport i ujrave te ndotur urban, llumrave septike dhe ujrave te zeza”, ku të jenë të përfshirë kodet 20 03 04, 20 03 06.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar në bazë të nenit të 79, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 44, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, si dhe Ligjit 116/2014 “Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që plotësojnë kërkesat e cilësisë për realizimin me sukses të kontratës

Për vet natyrën e veçantë, vendndodhjes dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rëndësishme që operatorët si zbatues, të kryejnë veprimtarinë me standardet e kërkuara të cilësisë. Sistemi i menaxhimit të cilësisë, mjedisit dhe shëndetit dhe sigurisë në punë janë standarte që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës për sa kohë do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës. Referuar në nenin 79 të ligjit 162/2020, parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit, shëndetit dhe sigurisë në punë.

Operatorët e huaj ekonomikë duhet të paraqesin të gjithë dokumentacionin e tyre në gjuhën shqip ose anglisht, si dhe në rastin e dokumenteve të lëshuara nga autoritete publikë, t'i certifikojnë ato me vulën "Apostille". Për vendet që nuk e kanë ratifikuar Konventën e Hagës, datë 05.10.1961 për "Heqjen e kërkesës për legalizim diplomatik e konsullor të dokumentave zyrtare të huaj", duhet të bëhen legalizimet e ketyre dokumentave në ambasadat, konsullatat ose zyrat respektive nga vendi i origjinës.

Ndarje në lote: NUK KA

Argumentimi në lidhje me Nenin 39, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për mos ndarjen në lote të procedurës së prokurimit:

Për procedurën e prokurimit me objekt "SHËRBIMI I MIREMBAJTJES SE RRJETIT HIDRIK PËR 3 VITE", Autoriteti Kontraktor vlerëson se kjo procedurë prokurimi nuk mund të ndahet në lote për arsye se:

Duke ndarë shërbimin në lote mund të kemi më shumë kontrata dhe kontraktorë të ndryshëm për të menaxhuar. Kjo mund të sjellë sfida dhe kosto në menaxhimin e kontratave dhe koordinimin ndërmjet OE.

Vetë infrastruktura e rrjetit të furnizimit me ujë duhet të trajtohet si një e vetme dhe ndarja në lote e monitorimit dhe mirëmbajtjes së këtij rrjeti nga disa operatorë shfaq problematika në cilësinë e shërbimit.

Koordinimi ndërmjet stafit teknik përgjegjës të APD dhe stafit teknik të disa OE do vështirësohej duke sjellë vonesa në dhënien e shërbimit dhe garantimin e cilës së tij.

Gjatë monitorimit dhe shërbimit të mirëmbajtjes hidrike mund të lindin problematika të ndryshme për sa i përket ndarjes së përgjegjësisë apo mos veprimit të operatorëve.

III. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë përshkruar saktë dhe në mënyrë të plotë duke qenë të paanshme, lidhur me kërkesat e Autoritetit Kontraktor për furnizimin me pajisjet elektronike duke u mbështetur në standardet e duhura kombëtare dhe ndërkombëtare, duke pasur parasysh garancitë përkatëse të këtyre artikujve, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", të ndryshuar.

Në përcaktimin e specifikimeve teknike për artikujt, objekt i kësaj procedure prokurimi (SIEM,EDR,VSCANNER,Workstation dhe TV), janë vendosur në përputhje me nevojat e institucionit për të garantuar funksionimin dhe arritjen e qellimeve të përcaktuara.

Për sa më sipër, specifikimet teknike nuk kanë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emri të veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ka ekzistuar një mënyrë e mjaftueshme e saktë e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, dhe është cituar fjala "ekuivalent" e përfshirë detyrimisht në këto specifikime.